

VENDIM
Nr. 604, datë 11.9.2019

**PËR NGRITJEN E SEKRETARIATIT TË KOMITETIT KOORDINUES TË
MINISTERIALIT TË MBROJTJES SË EVROPËS JUGLINDORE (SEDM-CC) DHE
TË KOMITETIT DREJTUES POLITIKO-USHTARAK / FORCËS PAQERUAJTËSE
SHUMËKOMBËSHE TË EVROPËS JUGLINDORE (PMSC/MPFSEE) NË
SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të marrëveshjes dhe të protokollit shtesë “Për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Evropës Juglindore”, ratifikuar me ligjin nr. 8544, datë 4.11.1999, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Sekretariatit të Komitetit Koordinues të Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM-CC) dhe të Komitetit Drejtues Politico-Ushtarak / Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore (PMSC/MPFSEE) në Shqipëri, në varësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së SEDM-CC-së dhe të PMSC/MPFSEE-së.

2. Sekretariati i SEDM-CC-së dhe i PMSC/MPFSEE-së të funksionojë deri më 1.7.2021.

3. Sekretariati i SEDM-CC-së dhe i PMSC/MPFSEE-së do të ketë kryetar zëvendësministrin e Mbrojtjes dhe do të përbëhet nga personel civil e ushtarak, si më poshtë vijon:

- a) 3 (tre) specialistë - civilë;
- b) oficeri i shtabit për operacionet - ushtarak;
- c) nëpunësi i protokollit - ushtarak;
- ç) përgjegjësi i administratës - ushtarak.

4. Personeli civil i Sekretariatit emërohet dhe lirohet nga detyra nga ministri i Mbrojtjes, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës, ndërsa personeli ushtarak emërohet dhe lirohet nga detyra nga ministri i Mbrojtjes, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ministria e Mbrojtjes të sigurojë mjediset dhe pajisjet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë e për funksionimin e Sekretariatit.

6. Paga e punonjësve civilë në pozicionet “Specialist” të jetë ajo e kategorisë IV-a, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë. Personeli ushtarak i Sekretariatit të trajtohet me pagë sipas gradës, në përputhje me nenin 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e ushtarakëve të Forcave të Armatosura.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

